

# RREGULLORE E BRENDSHME E AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE

## KREU II

### FUNKSIONET

#### Neni 4

##### Drejtori Ekzekutiv

1. Drejtori Ekzekutiv është titullari dhe organi drejtues i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

2. Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së, emërohet dhe lirohet nga detyra nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

2/1. Drejtori Ekzekutiv sipas përcaktimit të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 8, përgjigjet për vendosjen e përbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficencë.

2/2. Drejtori Ekzekutiv sipas përcaktimit të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, është Nëpunësi autorizues i institucionit, është përgjegjës dhe i raporton Ministrit për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësítë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

2/3. Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe koordinimin e riskut, punonjësve pjesë e strukturës së financës. Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Ai ushtron detyrat dhe funksionet të përcaktuara në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN-së dhe në këtë rregullore:

- Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së, është titullari i institucionit të AKBN-së, dhe ka përgjegjësinë për zbatimin e politikave qeveritare në fushën e zhvillimit, mbikqyrjes, shfrytëzimit racional të burimeve natyrore dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur, burimeve te rinovueshme të energjisë dhe hidroenergetik, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
- Përfaqëson AKBN në çështjet kombëtare e ndërkombëtare për fushat e veprimtarisë shtetërore që mbulon AKBN-ja dhe përgjigjet për veprimtarinë e saj, duke zbatuar kompetencat e caktuara në

- VKM Nr. 547, datë 09.08.2006, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", të ndryshuar, Statut- rregulloren e funksionimit të AKBN-së, si dhe në këtë rregullore;
- c. Drejtori Ekzekutivi AKBN-së, mund t'ia delegojë të drejtën e nënshkrimit me autorizim Zv. Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së, ose Drejtorëve të Drejtorive. Kjo e drejtë mund të revokohet në çdo kohë.
  - d. Organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e AKBN-së, nëpërmjet urdhraleve dhe udhëzimeve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me Statut-Rregulloren, përmbrëshjen e misionit, për të cilin është krijuar AKBN.
  - e. Drejtori Ekzekutivi AKBN-së, paraqet periodikisht dhe detyrimisht në mbyllje të çdo viti, raportin për veprimtarinë ekonomike e financiare të AKBN-së, në Këshillin Drejtues.
  - f. Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së, emëron punonjësit e AKBN- sipas strukturës organizative të miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.
  - g. Liron, apo shkarkon nga detyra, punonjësit e AKBN-së, si dhe jep masa administrative përrastet e shkeljes së disiplinës dhe etikës në institucion, si dhe raste të tjera, të përcaktuara në Statut- rregulloren e funksionimit të AKBN-së dhe legjislacioni i punës.
  - h. Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së ka të drejtë, që brenda kompetencave të tij t'u japë, një ose disa punonjësve të Agjencisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh.
  - i. Ka të drejtën dhe përgjegjësinë e administrimit të fondeve në bazë të buxhetit të miratuar nga Këshilli Drejtues dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.
  - j. Kërkon, kur e sheh të nevojshme, ndihmën e specializuar nga konsulentë jashtë AKBN-së ose studio profesionale brenda dhe jashtë vendit.
  - k. Miraton planet e punës të drejtorive të AKBN-së.
  - l. Raporton tek Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisëpër punën dhe veprimtarinë tekniko-ekonomike të AKBN, në mënyrë periodike;
  - m. Siguron zbatimin e detyrave që i ngarkohen AKBN-së nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe përgjigjet përrrealizimin e tyre;
  - n. Bashkërendon punën e drejtorive të AKBN-së, për të siguruar veprimitari sa më efektive të saj, si dhe organizon zhvillimin e takimeve me drejtuesit e sindikatave;
  - o. Kryeson Këshillin Teknik (organ kolegjial, vendimmarrës, i përhershëm), për shqyrtimin e projekteve të shfrytëzimit të burimeve natyrore;
  - p. Emëron anëtarët e Këshillit Teknik të shqyrtimit të projekteve të shfrytëzimit të burimeve natyrore;
  - q. Përfaqëson AKBN, në marrëdhëni me të tretët dhe nënshkruan kontrata;
  - r. Kërkon, kur e sheh të nevojshme, mbledhjen e Këshillit Drejtues;
  - s. Përveç kompetencave ose detyrave që parashikohen në Statut-Rregulloren e funksionimit të AKBN dhe në këtë rregullore ushtron edhe detyra të tjera, që i ngarkohen nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.